

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga kërkesa për Begajn, te thirrja për qeverinë! Gjyqtarët dalin me vendim të unifikuar: Respektoni Kush tetuesen për pagat, ose ndërpresim punën
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/nga-kerkesa-per-begajn-te-thirrja-per-qeverine-mbledhja-e-gjyqtareve--i400887
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 13:44:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 13:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	878983f937fff7efe47dfd1dc77b52a0477bb19445ce2812f38b8310c99fb622
TEKSTI	35e1e03230e4d8a1db21e88c4f857953f72496ade49a954673798c88c50ece75
PAMJA	487c5f05541739de359aa8202101b3e54bd279ac25db92c5d734255a27265333

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c5d1f1c055d24e4b4c0291b290aa3a0df44d652188823d6276864d7a9ad61fbb
E MËPARSHMJA	3b89d288ee3f62749fba002b259ca1f47b7e14107f6777d54722137606efe4a6
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c5d1f1c055d24e4b4c0291b290aa3a0df44d652188823d6276864d7a9ad61fbb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Aktualitet](#) 10 Shtator 2026, 15:37

Nga kërkesa për Begajn, te thirrja për qeverinë! Gjyqtarët dalin me vendim të unifikuar: Respektoni Kushtetuesen për pagat, ose ndërpresim punën

Shkruar nga Newsbomb



 Nga kërkesa për Begajn, te thirrja për qeverinë!

Zedhenesja

Ka përfunduar mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, ku janë marrë disa vendime të rëndësishme në lidhje me ngërçin e shkaktuar nga bllokimi i pagave nga Thesari i Shtetit për magistratët dhe administratën e tyre.

Pas mbledhjes, gjyqtarët kanë dalë me një deklaratë publike, ku bëhet me dije se ata nuk do të tërhiqen nga kërkesat e tyre, të cilat sipas tyre i kanë legjitime.

"Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve do të refuzojë të pranojë çdo propozim dhe zgjidhje ligjore, që nuk garanton paprekshmërinë e pagës dhe përfitimeve të tjera të ligjshme të gjyqtarëve, në parametrat ligjorë të konfirmuara nga vendimi nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. 435, datë 26 gusht 2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor", theksohet në deklaratë.

Po ashtu shoqata i ka bërë kërkesë Presidentit të Republikës, të shohë me rigorozitet të projektligjit të propozuar nga deputetët për pagat e gjyqtarëve.

Po ashtu në reagim nënvizohet se gjyqtarët do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e tyre me përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe me respekt të plotë për Kushtetutën e ligjin.

"Në rast se nuk veprohet menjëherë nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ekzekutimin e pagave, masat e ndërmarra nga pushteti gjyqësor do të përshkallëzohen deri në reduktimin dhe kufizimin përkohësisht të veprimtarisë gjyqësore, vetëm në shqyrtimin e çështjeve me natyrë urgjente dhe që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme gjyqësore", shtohet po ashtu.

Gjithashtu thirrje i bëhet edhe qeverisë dhe institucioneve të tjera, që t'i japin menjëherë fund kësaj gjendjeje dhe të përbushin detyrimet e tyre kushtetuese e ligjore.

Deklarata e plotë:

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, e thirrur në mënyrë të jashtëzakonshme për shkak të bllokimit të pagave të gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore, pasi shqyrtoi situatën e krijuar dhe qëndrimet institucionale të mbajtura gjatë këtyre ditëve, deklaroi sa vijon:

- Situata e krijuar nuk përbën një mosmarrëveshje të zakonshme financiare dhe as një konflikt për privilegje. Ajo prek drejtpërdrejt autoritetin e Kushtetutës, forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe funksionimin e rregullt të gjykatave. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15/2026 është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim. Asnjë organ shtetëror nuk mund t'i pezullojë, kushtëzojë ose neutralizojë efektet e tij me akt administrativ, me interpretim financiar apo me mosveprim.
- Pas datës 31 korrik 2026, formula e shpallur antikushtetuese nuk mund të vazhdojë të zbatohet. Mosveprimi i ligjvënësit brenda afatit të caktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk e ringjall normën e shfuqizuar dhe nuk krijon vakancë në mbrojtjen që neni 138 i Kushtetutës i njej pagës së gjyqtarit. Garancia kushtetuese nuk mund të vihet në pritje deri në një vendimarrje të ardhshme dhe as të varet nga vullneti i organit që administron fondet publike.
- Vendimi nr. 435, datë 26 gusht 2026, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është akti i organit kushtetues përgjegjës për administrimin e sistemit gjyqësor, i miratuar për zbatimin e vendimit të Gjykatës

Kushtetuese. Çdo kundërshtim ndaj tij duhet të ndiqet vetëm me mjetet dhe përpara organeve që parashikon ligji. Derisa të ndryshohet ose të shfuqizohet në rrugë ligjore, ai prodhon pasojë dhe duhet të zbatohet. Thesari nuk ka kompetencë të kryejë kontroll kushtetues apo gjyqësor mbi të dhe nuk mund të shndërrohet nga mekanizëm ekzekutimi, në mekanizëm pezullimi.

4. Edhe nëse pretendohet se ekziston një çështje për t'u zgjidhur lidhur me pagën pas datës 31 korrik 2026, kjo nuk mund të përdoret si shkak për të bllokuar detyrimet e prapambetura. Për to, paragrafi 110 i vendimit nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese ka dhënë zgjidhje të shprehur. Një detyrim i përcaktuar për një periudhë të përfunduar nuk mund të mbahet peng nga debati për një periudhë tjetër. Ai duhet të ekzekutohet pa vonesë dhe pa u kushtëzuar nga miratimi i një ligji të ri.

5. Bllokimi i pagave ka prekur njëkohësisht gjyqtarët dhe administratën gjyqësore. Sekretarët gjyqësorë, kancelarët, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të gjykatave, janë pjesë e domosdoshme e funksionimit të drejtësisë dhe nuk mund të mbajnë mbi familjet e tyre pasojat e një mosmarrëveshjeje që nuk e kanë krijuar. Lënia e tyre pa pagë cenon dinjitetin njerëzor e profesional, dëmton funksionimin e gjykatave dhe, në fund, kufizon shërbimin e drejtësisë ndaj qytetarit. Pagesat e administratës gjyqësore nuk janë pjesë e qëndrimit refuzues të Ministrisë së Financave dhe degëve të thesarit për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Paga e gjyqtarit është pjesë e statusit kushtetues dhe garanci konkrete e pavarësisë në ushtrimin e funksionit. Ajo nuk është favor i ekzekutivit, shpërblim që jepet sipas vlerësimit të tij apo instrument për të shprehur miratim ose pakënaqësi ndaj vendimmarrjes gjyqësore. Mbrojtja e kësaj garancie nuk i shërben vetëm gjyqtarit; ajo mbron qytetarin, i cili ka të drejtë të gjykohet nga një gjyqtar i pavarur nga çdo pushtet tjetër.

7. Buxheti i shtetit është instrument financiar i Republikës dhe duhet të sigurojë funksionimin e të gjitha pushteteve të saj. Mungesa e planifikimit, nevoja për rishpërndarje fondesh ose vështirësi të tjera administrative nuk mund ta kthejnë një detyrim kushtetues e ligjor në detyrim fakultativ. Në një shtet kushtetues nuk është Kushtetuta ajo që përshatet me buxhetin; është buxheti që duhet të mundësojë zbatimin e Kushtetutës.

8. Përballë kësaj situatë, Mbledhja e Përgjithshme vlerëson se nuk ka më vend për shtyrje, interpretime që relativizojnë detyrimin apo zgjidhje të pjesshme që e lënë gjendjen të vazhdojë. Rivendosja e ligjshmërisë kërkon veprime të menjëhershme, të plota dhe të verifikueshme nga institucionet përgjegjëse. Për këtë arsye,

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve kërkon:

Zhblokimin e menjëhershëm dhe pagesën pa asnjë vonesë të pagave të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore;

Zbatimin e plotë të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, të vendimit nr. 435, datë 26 gusht 2026, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të urdhrave të nëpunësve autorizues të gjykatave, për aq kohë sa këto të fundit janë në fuqi;

Sikurse organet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kanë njohur dhe ekzekutuar detyrimet ligjore, duke zbatuar referencën e pagës sipas parametrave ligjorë të konfirmuara nga vendimi nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. 435, datë 26 gusht 2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve pret nga Ministria e Financave dhe organet në varësi, që të mos zbatojnë vetëm detyrimet ligjore që gjyqtarët kanë por edhe të drejtat e tyre;

Fillimin e menjëhershëm të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura sipas zgjidhjes së përcaktuar në paragrafin 110 të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, si një detyrim kushtetues i cili nuk varet nga miratimi i ligjit të ri;

Miratimin pa vonesë të kuadrit të ri ligjor, në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nenin 138 të Kushtetutës, garancitë kushtetuese të statusit të magjistratit dhe pas një konsultimi real me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë;

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve do të refuzojë të pranojë çdo propozim dhe zgjidhje ligjore, që nuk garanton paprekshmërinë e pagës dhe përfitimeve të tjera të ligjshme të gjyqtarëve, në parametrat ligjorë të konfirmuara nga vendimi nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. 435, datë 26 gusht 2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

Ndalimin e çdo praktike administrative që pengon funksionimin financiar të gjykatave ose vendos gjyqtarët dhe administratën gjyqësore përpara pasigurisë së përsëritur për pagën e tyre;

Marrjen e përgjegjësiwe institucionale nga çdo organ që, sipas Kushtetutës dhe ligjit, ka kompetencë për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera dhe për të rivendosur menjëherë gjendjen e ligjshme;

Ndërmarrja e çdo lloj mjeti ligjor me natyrë administrative, civile dhe kushtetuese që bën të mundur ekzekutimin me efekt të menjëhershëm të listëpagesave të pagave të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, në zbatim të vendimit nr. 435, datë 26.8.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe urdhrave të titullarëve të gjykatave respektive;

Ndërmarrja e të gjitha iniciativave për adresimin e situatës me organizatat ndërkombëtare, veçanërisht me Komisionin Evropian, instancat e tjera ndërkombëtare si dhe përfaqësitë diplomatike të huaja, të angazhuara në mbështetjen dhe monitorimin e ndërtimit të shtetit të së drejtës dhe reformës në drejtësi në Shqipëri;

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve i kërkon Presidentit të Republikës, në zbatim të kompetencave të tij kushtetuese, të angazhohet për respektimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore;

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve i kërkon Presidentit të Republikës monitorimin me rigorozitet të projektligjit të propozuar nga deputetët e Kuvendit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, me qëllim që propozimet për ndryshime të ligjit të jenë në përputhje me frymën, standardet dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15/2026 dhe të sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të tij;

Në rast se nuk veprohet menjëherë nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ekzekutimin e pagave, masat e ndërmarrja nga pushteti gjyqësor do të përshkallëzohen deri në reduktimin dhe kufizimin përkohësisht të veprimtarisë gjyqësore, vetëm në shqyrtimin e çështjeve me natyrë urgjente dhe që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme gjyqësore.

Këto kërkesa nuk janë objekt negocimi, sepse nuk burojnë nga një interes i çastit dhe as nga një pretendim i pakonfirmuar. Ato burojnë nga Kushtetuta, ligji dhe një vendim përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese. Dialogu institucional është i nevojshëm për të përcaktuar mënyrën e zbatimit, por nuk mund të përdoret për të shtyrë, relativizuar apo vënë në diskutim vetë detyrimin për zbatim.

Gjyqtarët e Republikës do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e tyre me përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe me respekt të plotë për Kushtetutën e ligjin. Kjo përgjegjësi nuk nënkupton heshtje përballë cenimit të garancive të pushtetit gjyqësor. Vetëpërmbytja e gjyqtarit është virtyt institucional; ajo nuk mund të interpretohet si praninë e paligjshmërisë apo si dorëzim përballë saj.

Mbledhja mbështet përdorimin e të gjitha mjeteve kushtetuese dhe ligjore për rivendosjen e ligjshmërisë dhe kërkimin e përgjegjësisë, duke ruajtur në çdo rast paanshmërinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave që mund të thirren për shqyrtimin e këtyre çështjeve. Reagimi ynë do të jetë në një zë të vetëm, i matur në zgjedhjen e mjetit dhe i vendosur deri në zbatimin e plotë të ligjit.

Mbledhja e Përgjithshme u bën thirrje Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës që t'i japin menjëherë fund kësaj gjendjeje dhe të përmbushin detyrimin e tyre kushtetues e ligjor. Vazhdimi i bllokimit pas këtij qëndrimi të përbashkët nuk mund të konsiderohet më një paqartësi teknike: ai do të përbënte vijim të vetëdijshëm të një situatë që cenon autoritetin e Gjykatës Kushtetuese, pavarësinë e gjyqësorit dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Gjyqësori nuk kërkon epërsi ndaj pushteteve të tjera dhe nuk pranon nënshtrim ndaj tyre. Kërkon vetëm atë që Kushtetuta urdhëron: që secili pushtet të ushtrojë kompetencat e veta, të respektojë kufijtë e tjetrit dhe t'u bindet vendimeve përfundimtare të drejtësisë kushtetuese.

Kushtetuta nuk negociohet. Vendimi përfundimtar nuk pezullohet. Detyrimi ligjor nuk mbahet peng. Pagat duhet të zhblokojnë dhe vendimi duhet të zbatohet menjëherë.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Aktualitet

[Saimir Kola nuk ia doli dot! 40-vjeçari ndërron jetë në Itali, erdhi në Lezhë për dasmën e mbesës por bombola e gazit i dogji 90% të sipërfaqes së trupit](#)

E Enjte 16:10

Aktualitet

[5 milionë tonë gaz në vit! Projekti i madh amerikan në Shqipëri, si pritet të furnizohet Ballkani](#)

E Enjte 16:06

Aktualitet

[Tërmet në Shqipëri, ja ku ishte epiqendra dhe sa ishte forca e lëkundjeve](#)

E Enjte 16:07

Aktualitet

[452 mijë tonë naftë ruse të transportuara, Shqipëria bllokon cisternën e “flotës hije” në Durrës](#)

E Enjte 15:55

Aktualitet

[Specat e fermerit nga Fieri “të mbytur” me pesticide, Kroacia “heq qafe” 14.7 tonë produkt](#)

E Enjte 15:33

Aktualitet

[Situata e zjarreve në vend, Ministria e Mbrotjtjes bën BILANCIN: 10 vatra ende aktive, qindra forca dhe mjete në terren](#)

E Enjte 15:20

Aktualitet

[Blutë e Vlorës prangosin dy “skifterët” që vodhën 3 makina, 40 vjeçari grabiti Benz-in deri në Orikum dhe më pas tentoi të merrte Jeep-in \(EMRAT-VIDEO\)](#)

E Enjte 14:52

Aktualitet

[SPAK sqaron mosrealizimin e takimit të avokatëve të huaj me Veliajn: Nuk ka refuzim, por pamundësi organizative](#)

E Enjte 14:43

Aktualitet

[Edi Rama pranon mungesën e Veliajt, jep lajmin e mirë për banorët e Tiranës: Kryeqyteti pa kokë solli shumë viktima! Do përfundojë rindërtimi i banesave](#)

E Enjte 14:31

Aktualitet

[Kallëzojnë ministrin Malaj, por dosja mund të përfundojë “në shtëpinë” e tyre! Dy nga denoncuesit janë gjyqtarë të GJKKO, kush do ta gjykojë çështjen?](#)

E Enjte 14:18

Aktualitet

[SPAK zbërthen një tjetër Call Center mashtrues te "Rruga e Kavajës", paratë që ua merrnin europianëve i kthenin në kriptovaluta, ekzekutohen 8 masa sigurie](#)

E Enjte 13:34

Aktualitet

[Protestuesit në Marinëz takim me përfaqësuesit e Bankers, njërin prej tyre u përpoqën ta “tundonin”: Uli protestat, do të japim 5 milionë \(VIDEO\)](#)

E Enjte 13:24

Aktualitet

[Me automatikë dhe pistoletë kërcënuan dy persona pas një sherri me një të mitur, blutë e Shkodrës shpallin në kërkim 2 autorët](#)

E Enjte 13:09

Aktualitet

[Tre të rejat e tërhoqën për flokësh dhe e rrahën, flet për herë të parë 17-vjeçarja që u dhunua në Fier: Më thanë pse e ke puthur të dashurin tim?! \(INTERVISTA E PLOTË\)](#)

E Enjte 12:59

Aktualitet

[Policia njoftoi shoqërimin e 16 protestuesve, qytetarët nuk humbin kohë, bëhen bashkë dhe nisen për te Komisariati numër 3](#)

E Enjte 12:45 Newsbomb

Aktualitet

[Shpërthimi tek “Eida” në Brryl, çfarë DËSHMUAN tre punonjësit e plagosur: Po furnizonim një makinë me gaz kur...](#)

E Enjte 12:22

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Showbiz & Lifestyle

[Pas zërave për gjendjen shëndetësore, reagon Xheneta Fetahu: Merruni me jetën tuaj, do të merren masat e duhura](#)

E Enjte 16:15

Sporti

[HISTORIKE në futbollin europian e më gjerë, bukuroshja 22-vjeçare bëhet trajnere te ekipi i meshkujve](#)

E Enjte 15:54

[Zbulo më shumë artikuj >](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#) 



[18 vjeçari "nuk zë mend", Policia i tregon vendin: Ishte në arrest shtëpie për vjedhje, doli dhe...](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)



[E pazakontë tek "Mbretëresha Geraldinë", vjen në jetë në lindje me natyrale djali me peshë 5.1 kg](#)



[Goditet grupi i drogës në Sarandë, 20 persona të prangosur, shpërndanin lëndën narkotike](#)

op ed

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor](#)

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse "Jo"-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë](#)

E Diel 18:33



-
-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtor i Përgjithshëm: Retin Toka

NIPT: L42417011Q

[Abonohu te Revista](#)

Created and monetized by  **mediadesk**

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

Merr lajme me email

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  **mediadesk**